

Vendim nr. 228 datë 22.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 22.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (V) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: VJOLLCA PUSTINA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 9344, datë 29.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1719, datë 15.07.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-3964 (509), datë 25.09.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 18, 41, 42, 44, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka qenë e regjistruar si person fizik, me aktivitet “laborator dhe klinikë mjekësore”, ku ka qenë i punësuar edhe mjeku gjinekolog-imazherist Sh.B., i cili e ka ndjekur klinikisht gjatë shtatzanisë së dytë shtetasen V.B.

2. Në muajin e tretë të shtatzanisë shtetasja V.B. ka kryer vizitën e parë në klinikën private “Moskat” në Tiranë, ku mjeku Sh.B. gjithashtu punonte. Në përfundim të kontrollit mjeku ka vlerësuar se shtatzania e saj ishte brenda parametrave normalë dhe se fetusin ishte i seksit femër. Pas një muaji nga ekzaminimi i parë mjekësor imazherik (obsetrik/gjinekologjik) dhe nënshtrimit të një sërë analizave, shtetasja V.B. ka kryer sërish vizitë mjekësore dhe mjeku Sh.B. i ka bërë të ditur se parametrat ishin normalë, se në atë moment nuk ishte e domosdoshme bërja e një ekoje tjetër dhe se në javën e 23-të të shtatzanisë ishte e rëndësishme të bëhej ekoja morfologjike, nga e cila përcaktohej dhe shikohej qartë struktura morfologjike e fëmijës, gjymtyrët, organet, tiparet etj. Në datën 24.06.2011, në javën e 23-të të shtatzënisë, V.B. ka kryer ekon morfologjike në klinikën mjekësore private të kërkueses nga mjeku Sh.B. Në vazhdimësi të shtatzanisë së saj ajo ka kryer edhe tre eko të tjera morfologjike në këtë klinikë, po nga mjeku Sh.B., i cili i ka bërë të ditur se nuk ka evidentuar asnjë patologji ose anomali të fetusit dhe se shtatzënia e saj ishte normale. Në datën 14.10.2011, e asistuar nga mjeku Sh.B. dhe personeli mjekësor, V.B. ka lindur vajzën e saj, e cila ka rezultuar me anomali fizike, pasi i mungonte tërësisht krahu i majtë.

3. Shtetasja V.B., duke vepruar edhe si përfaqësuese ligjore e fëmijës, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi në kuadër të cenimit të së drejtës për jetë private dhe familjare të parashikuar nga neni 8 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosinformimit të nënës për mundësinë e lindjes së fëmijës me aftësi të kufizuara “*wrongful life*”. Ajo ka kërkuar nga kërkuesja, në cilësinë përfaqësuese ligjore të klinikës private dhe mjeku Sh.B., shpërblimin solidarisht të dëmit pasuror e jopasuror të shkaktuar si pasojë e gabimit profesional të kryer nga mjeku, për moskonstatimin dhe mosinformimin në kohë të anomalisë fizike të vajzës së saj. Me vendimin nr. 9344, datë 29.09.2014, gjykata e rrethit ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, detyrimin e kërkueses dhe të mjekut Sh.B. t’u paguajnë shtetaseve F.B. dhe V.B. shumën 10.000.000 lekë. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga kërkuesja.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1719, datë 15.07.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit, detyrimin e kërkueses të dëmshpërblejë paditëset në shumën 2.000.000 lekë, si edhe detyrimin e Sh.B. t'i dëmshpërblejë ato në shumën 500.000 lekë. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs nga palët ndërgjyqëse.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3964 (509), datë 25.09.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit.

6. Në datën 02.06.2025 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 19.06.2025, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkueses

7. **Kërkuësja**, më mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

7.1.E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

7.1.1. *Parimit të kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë*, në aspektin e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit material e procedural. Gjykatat e faktit kanë shkëlur dispozitat procedurale që rregullojnë mënyrën e marrjes dhe vlerësimit të provave. Gjykata e rrethit e ka legjitimuar pasivisht në proces, edhe pse nuk kishte asnjë marrëdhënie juridike me veprimin e supozuar të dëmshëm, thjesht për faktin e ekzistencës së saj si person fizik, i regjistruar në regjistrin e aktivitetit tregtar. Interpretimi i kësaj gjykate, i gjetur i drejtë edhe nga Gjykata e Lartë, vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 618 të Kodit Civil (KC). Në rastin konkret, gjykatat nuk kanë provuar ekzistencën e një kontrate punësimi midis saj dhe mjekut Sh.B., ndaj përcaktimi i përgjegjësisë së saj në mungesë të provës së ligjshme përbën edhe *cenim të sigurisë juridike*. Pasaktësitë në vlerësimin e provave nga gjykatat e faktit dhe mangësitë e theksuara në arsyetimin e tyre, si për përgjegjësinë solidare të të paditurve, masës së dëmshpërblimit, pozitës procedurale të kërkueses, duke e trajtuar si punëdhënëse të mjekut Sh.B., edhe pse nuk ekzistonte asnjë provë që të vërtetonte këtë marrëdhënie, kanë bërë të pamundur marrjen e një vendimi nga Gjykata e Lartë.

- 7.1.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi në dosjen gjyqësore nuk ekziston asnjë provë që provon ekzistencën e një kontrate pune ndërmjet kërkueses dhe mjekut Sh.B., ose kryerjen e ndonjë pagese, ose të sigurimeve shoqërore ndaj tij. Arsyeja e vetme e legjitimitetit pasiv të kërkueses është bërë nga gjykatat për të mbështetur pretendimet e palës paditëse.
- 7.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është i papritur, i paprecedent dhe i paparashikueshëm. Gjykatat kanë krijuar përgjegjësi edhe në mungesë të ekzistencës së fajit.
- 7.1.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk kanë analizuar faktet dhe elementet e përgjegjësisë civile në përputhje me kërkesat e ligjit. Arsyetimi i vendimeve të tyre është formal, i painedividualizuar dhe i kopjuar në të tria shkallët e gjykimit. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar, pasi i mungon analiza e fakteve dhe provave dhe nuk jep asnjë argument ligjor se përse duhej të prishej vendimi i gjykatës së apelit dhe të lihej në fuqi vendimi i gjykatës së shkallës së parë, kur të dyja këto gjykata, në mungesë të provave, kanë pranuar *apriori* se Sh.B. ishte i punësuar nga kërkuesja. Gjykata e Lartë nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve që janë ngritur në rekurs, të cilat konsistojnë në shkeljen e parimeve të barazisë përpara ligjit, barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, si dhe të sigurisë juridike. Gjykata e Lartë e ka trajtuar kërkuesen si të përgjegjshme për veprimet e një personi tjetër (mjekut), pa ekzistencën e një marrëdhënieje pune në kundërshtim me *parimin e individualizimit të përgjegjësisë*.
- 7.1.5. *Së drejtës për një mjet ligjor efektiv*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka shqyrtuar dhe argumentuar në mënyrë të plotë e të drejtë pretendimet thelbësore të saj.
- 7.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, pasi gjykatat kanë zgjeruar rrethin e të paditurve përtej kriterëve të përcaktuar në ligj. Ndërsa për mjekun është ndjekur një analizë e veprimit të tij profesional, gjykatat e kanë marrë të mirëqenë përgjegjësinë civile të kërkueses për dëmin e shkaktuar vetëm për shkak të ekzistencës së saj si subjekt tregtar, duke e vendosur në pozitë të pabarabartë dhe duke e ngarkuar me një barrë disproporcionale për të provuar diçka që nuk ekziston, në mungesë të çdo prove që e lidh atë juridikisht me ngjarjen.

7.3. *E drejta e pronës*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë e ka ngarkuar me detyrimin për të paguar një shumë të konsiderueshme në formë dëmshpërblimi pa një bazë ligjore dhe faktike të provuar, si dhe pa përmbushur testin e proporcionalitetit. Duke mos ekzistuar një bazë ligjore që e lidh me fajin e supozuar të mjekut, vendosja e një detyrimi prej 10 milionë lekësh përbën një ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën e saj për të disponuar pasurinë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

8. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kolegji vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, rezulton se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Kolegji çmon se kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, referuar shkresës së kësaj gjykate, është bërë i disponueshëm për palët në datën 11.02.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 02.06.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të parimit të kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, parimit të sigurisë juridike, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, së drejtës për mjete ligjore efektive, si dhe parimit të barazisë përpara ligjit dhe së drejtës së pronës, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues.

13. Në ankimin kushtetues individual lidhur me *cenimin e parimit të kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë*, kërkuesja ka pretenduar se gjykatat e faktit kanë shkelur dispozitat procedurale që rregullojnë mënyrën e marrjes dhe të vlerësimit të provave. Sipas saj, pasaktësitë në vlerësimin e provave, si dhe mangësitë e theksuara në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të faktit e kanë bërë të pamundur marrjen e një vendimi nga Gjykata e Lartë.

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre është në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet për to janë, po ashtu, në kompetencë të saj (*shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën e mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre (*shih vendimin nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këtë standard kushtetues, në rastin konkret, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkueses për vlerësimin e provave nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, ndaj, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim. Ndërsa për sa u përket pretendimeve për marrjen e provave, Kolegji vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të përcaktojë në këndvështrimin kushtetues provat për të cilat ka ngritur pretendime në drejtim të kushtetutshmërisë e të ligjshmërisë së marrjes së tyre. Prandaj, edhe nën këtë aspekt, ky pretendim i saj nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, kërkuesja ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë është i papritur, i paprecedent dhe i paparashikueshëm.

Gjykatat kanë krijuar përgjegjësi edhe në mungesë të ekzistencës së fajit. Gjithashtu, sipas kërkukses, gjykatat nuk kanë provuar ekzistencën e një kontrate punësimi midis asaj dhe mjekut Sh.B., ndaj përcaktimi i përgjegjësisë së saj në mungesë të provës së ligjshme përbën edhe cenim të këtij parimi. Të njëjtat argumente kërkuessa i ka paraqitur edhe në lidhje me *parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*.

16. Kolegji, duke mbajtur në vëmendje se parimi i sigurisë juridike për vendimet gjyqësore sipas jurisprudencës së Gjykatës nënkupton që nëse gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*), vlerëson se argumentet e paraqitura nga kërkuessa nuk i referohen një vendimi gjyqësor të formës së prerë, prandaj edhe ky pretendim i saj, nën këtë këndvështrim, nuk do të merret në shqyrtim. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se, në thelb, argumentet në mbështetje të këtij pretendimi, si dhe të atij për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit lidhen me standardin e arsytimit të vendimit, ndaj do të shqyrtohen në lidhje me këtë standard.

17. Për sa u përket pretendimeve të tjera, të lidhura me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuesses kanë të bëjnë, në thelb, me interpretimin që gjykatat i kanë bërë legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë civile për dëmin jashtëkontraktor, si pasojë e gabimit, moskonstatimin në kohë dhe mosinformimin me tej për anomalitë e foshnjës nga mjeku i klinikës që ajo drejtonte, si dhe arsytimin e tyre në këtë drejtim, Kolegji çmon t'i trajtojë ato në vijim në drejtim të *së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*.

18. Kërkuessa ka pretenduar se i është cenuar edhe e drejta e pronës, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë e ka ngarkuar me detyrimin për të paguar një shumë të konsiderueshme në formë dëmshpërblimi, pa një bazë ligjore dhe faktike, duke ndërhyrë në të drejtën e saj për të disponuar pasurinë. Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuesses për cenimin e së drejtës së pronës parashtrohen në drejtim të detyrimit të vendosur ndaj saj për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar paditëseve, si rrjedhojë e veprimeve/mosveprimeve të mjekut të klinikës së saj. Në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor, Kolegji do të analizojë fillimisht rregullsinë e procesit gjyqësor dhe në varësi të rezultatit do të shqyrtojë ose jo edhe këtë pretendim të kërkuesses.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

19. Kërkuesja ka pretenduar se arsyeja e vetme e legjitimitetit të saj në gjykim është bërë për të mbështetur pretendimet e palës paditëse. Vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm janë të paarsyetuara, pasi u mungon analiza e fakteve dhe e provave. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i ka trajtuar të gjitha pretendimet thelbësore të saj dhe nuk jep asnjë argument ligjor se përse duhej të prishej vendimi i gjykatës së apelit e të lihej në fuqi vendimi i gjykatës së shkallës së parë, kur të dyja këto gjykata, në mungesë të provave, kanë pranuar *apriori* se Sh.B. ishte i punësuar nga kërkuesja. Kjo gjykatë e ka trajtuar kërkuesen si të përgjegjshme për veprimet e një personi tjetër (mjekut), pa ekzistencën e një marrëdhënieje pune në kundërshtim me parimin e individualizimit të përgjegjësisë.

20. Për sa i përket së drejtës së aksesit, në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse ajo, përpara së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimin nr. 31, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Po kështu, Gjykata ka theksuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar gjithashtu se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë

të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, në rastin konkret, Kolegji do të shqyrtojë në vijim nëse gjykatat e zakonshme gjatë procesit gjyqësor u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuases, si dhe nëse interpretimi që ato i kanë bërë legjislacionit në fuqi për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues.

23. Kolegji vëren se shtetaset V.B. dhe F.B. i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të ardhur si rezultat i gabimit profesional të kryer nga i padituri Sh.B. Në përfundim të gjykimit të çështjes, gjykata e rrethit ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e kërkuases dhe Sh.B. t’u paguajnë paditëseve shumën 10.000.000 lekë, për shkak të konsumimit prej tyre të faktit të paligjshëm në të tre elementet objektive dhe subjektive të tij. Sipas gjykatës, mjeku Sh.B. i kishte të gjitha mundësitë dhe detyrimin të shikonte anomalinë fizike të fëmijës dhe të informonte nënën. Fajësia e tij në ushtrimin e detyrës është konstatuar edhe nga Këshilli Rajonal i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, i cili, me vendimin nr. 6, datë 20.06.2012, ka marrë masën “Vërejtje me shkrim dhe paralajmërim për heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit”. Po kështu, përgjegjësi për dëmet e ardhura paditëseve mban edhe klinika, si punëdhënëse e të paditurit në kohën kur ka ndodhur ngjarja, bazuar kjo në nenin 618 të KC-së (*shih faqet 23-26 të vendimit nr. 9344, datë 29.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

24. Gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit, duke vlerësuar se përgjegjësia për dëmet e ardhura paditëses i mban punëdhënësjë e klinikës mjekësore. Sipas kësaj gjykate, gjatë hetimit ka rezultuar e provuar se në kohën kur ka ndodhur ngjarja kërkuësja ka qenë në rolin e punëdhënëses të të paditurit Sh.B. dhe, bazuar në nenin 618 të KC-së, do të duhet të mbajë përgjegjësi, duke u detyruar t’i dëmshpërblejë ato. Lidhur me masën e dëmshpërblimit, për shkak të shkallës së fajësisë, kërkuësja detyrohet të paguajë dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar në shumën 2.000.000 lekë, ndërsa i padituri Sh.B. në shumën 500.000 lekë (*shih faqen 19 të vendimit nr. 1719, datë 15.07.2016 Gjykatës së Apelit Tiranë*).

25. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, me arsyetimin se gjykatat më të ulëta kanë provuar plotësisht që janë plotësuar të gjitha elementet thelbësore të përgjegjësisë civile jashtëkontraktore, ndaj në këtë rast gjejnë zbatim rregullimet e përgjithshme të KC-së dhe rregullimet e posaçme të

legjislacionit për dëmet jashtëkontraktore të shkaktuara të tretëve nga mjekimi i pakujdesshëm, pasi provohet paligjshmëria e veprimit dhe faji i shkaktuesit të dëmit. Nga analiza e provave të administruara në proces ka rezultuar se edhe kërkuesja, në cilësinë e personit fizik që ushtron aktivitet privat shëndetësor përmes subjektit “klinike laboratorike”, mban përgjegjësi solidare për dëmin e shkaktuar paditëseve. Kjo për arsye se ajo ka qenë punëdhënëse e mjekut dhe, si e tillë, është përgjegjëse për përzgjedhjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin profesional të stafit mjekësor që ka punësuar. Gjykata e rrethit ka argumentuar me të drejtë për përgjegjësinë solidare, duke konkluduar se në kushtet që kërkuesja ka qenë punëdhënëseja e Sh.B., bazuar në nenin 618 të KC-së, mban përgjegjësi në mënyrë solidare me të paditurin tjetër. Në kushtet kur veprimtaria mjekësore përfshin jo vetëm ofrimin e shërbimeve, por edhe detyrimin për të respektuar standardet profesionale dhe rregullat ligjore në ushtrimin e kësaj veprimtarie, në mënyrë të drejtë gjykata e rrethit ka konstatuar ekzistencën e përgjegjësisë së përbashkët civile të të dy të paditurve, duke urdhëruar shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror që u është shkaktuar paditëseve, si pasojë e këtyre veprimeve dhe mosveprimeve të paligjshme. Sipas gjykatës organizimi i veprimtarisë mjekësore dhe mënyra e ushtrimit të saj rregullohet nga ligji dhe jo nga kontrata. Prandaj, realizimi ose jo i kontratave formale për ofrimin e një shërbimi mjekësor për pacientin nuk afekton mënyrën e realizimit të veprimtarisë mjekësore, e cila mbetet e ushtrohet sipas dispozitave të ligjit të kohës nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, që rregullojnë këtë veprimtari dhe mungesa e kësaj kontrate formale, ashtu siç ka pretenduar kërkuesja në rekursin e saj, nuk e përjashton atë nga përgjegjësia solidare civile (*shih paragrafët 74, 75 dhe 76 të vendimit nr. 00-2024-3964, datë 25.09.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

26. Në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme, Kolegji vëren se, bazuar në faktet dhe provat e rezultuara gjatë gjykimit, gjykatat e fakti kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkueses për mungesën e përgjegjësisë së saj për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, duke dhënë përgjigje të arsyetuara se, bazuar në parashikimet e KC-së, përgjegjësia e punëdhënësit, si rezultat i dëmeve të shkaktuara nga punonjësit e tij, përbën përgjegjësi me faj, për shkak të detyrimit që punëdhënësi ka jo vetëm në përzgjedhjen, por edhe në mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre. Sipas këtyre gjykatave, ndërsa mjeku kishte detyrimin dhe mundësitë për të verifikuar anomalinë fizike të fëmijës dhe të informonte nënën për këtë anomali, përgjegjësia për dëmin e shkaktuar përfshin edhe klinikën, si punëdhënëse e tij. Ligjshmëria e vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta i është

nënshtuar në vijim kontrollit të Gjykatës së Lartë, e cila nuk ka konstatuar shkelje të ligjit material e procedural nga ato gjykata. Në vlerësim të këtyre vendimmarrjeve, Kolegji Civil ka vënë në dukje konkluzionin e arritur nga gjykatat më të ulëta se dëmi është shkaktuar me faj dhe se përcaktimi prej tyre i përgjegjësisë solidare së kërkueses, si punëdhënëse e Sh.B., është e bazuar në dispozitat e përgjithshme të KC-së dhe rregullimet e posaçme të legjislacionit për dëmet jashtëkontraktore, që rregullojnë institutin e dëmit jashtëkontraktor, si dhe në rregullimet ligjore e nënligjore të organizimit të veprimtarisë mjekësore.

27. Gjithashtu, Kolegji vëren se vendimet gjyqësore objekt kërkesë përmbushin standardet kushtetuese të arsytimit të vendimit gjyqësor. Vendimet e gjykatave përmbajnë pretendimet e palëve, analizën e provave dhe faktet e pranuar, ligjin e zbatueshëm dhe analizën e tij në kontekst të rrethanave të rastit konkret. Gjykatat e faktit kanë analizuar pretendimet e parashtruara gjatë gjykimit dhe në ankim, si për sa u përket fakteve, ashtu edhe për zbatimin e ligjit. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë tregon vendimmarrjen e gjykatave të faktit, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Në vlerësimin e Kolegjit, në kundërshtim nga sa pretendon kërkuësja, qëndrimet e gjykatave të zakonshme nuk rezultojnë alogjike dhe as arbitrare në aspektin kushtetues, në kuptimin që të bien ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Në këtë situatë, në kushtet kur kërkuësja ka ushtruar lirisht të drejtën e saj për t'iu drejtuar gjykatave, duke marrë përgjigje përfundimtare dhe të arsyetuar për shkaqet e përcaktimit të detyrimit solidar të saj në shpërblimin e dëmit, Kolegji çmon se pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

28. Nisur nga sa më lart, në kushtet kur pretendimet për proces të rregullt ligjor të ngritura nga kërkuësja janë haptazi të pabazuara, Kolegji nuk do të vijojë më tej me shqyrtimin e pretendimit të saj për cenimin e së drejtës së pronës për shkak të detyrimit të vendosur ndaj saj për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar paditëseve (*shih paragrafin 18*), duke e vlerësuar, mbi bazën e të njëjtave konsiderata, si haptazi të pabazuar.

29. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.